



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:097519

Datë: 21.10.2020

Numri i dokumentit: 01206172

C.nr.3/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerim Beshtica dhe zyrtarën ligjore Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. K.e S., me seli në P..., pa nr., kundër të paditurit Xh. M nga Gj , me objekt kontesti- rimburesim i dëmit material dhe jomaterial me vlerë të kontestit prej... euro, jashtë seancës, më datën 21.10.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e B. K. e St, me seli në P dhe DETYROHET i padituri Xh.t M nga Gj që paditësit në emër të rimburesimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës .., t'ia paguajë shumën prej 180.00 (njëqind e tetëdhjetë) euro, me kamatëvonesë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 21.10.2020 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, ka paraqitur padi kundër të paditurit paditurit Xh. M nga Gj, pa nr., për rimburesim të dëmit material dhe jomaterial, duke theksuar se i padituri me datën ...rreth orëska shkaktuar aksident trafiku me Automjetin Motoçikletë, i cili nga pakujdesia i ka shkaktuar dëm të dëmtuarës S.M. Automjeti me të cilin ka shkaktuar aksidentin i padituri, ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Si rezultat i këtij aksidenti, Byroja Kosovare e Sigurimit i ka kompenzuar dëmin të dëmtuarës, në pajtim me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Paditësi i është drejtuar të paditurit në procedurë jashtëgjyqësore, por nuk kanë arritur marrëveshje. Paditësi i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrojë të paditurin që paditësit të i rimburesojë shumën prej ...euro, në emër të rimburesimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës ...në Gj..., dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar,

duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës. Si provë ka bashkëngjitur: Raportin policor të aksidentit Nr....., Aktvendimin Regj.nr..... ujdia jashtëgjyqësore e datës..., urdhërtransferi bankar i datës 04.08.2015.

I padituri, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e pranon kundërvajtjen në kërkesëpadinë e paditësit, mirëpo ka kërkuar që të lirohet nga pagesa e këtij borxhi, pasi që deklaroi se është në gjendje të rëndë ekonomike, ngase i njëjti jeton së bashku me bashkëshorten e tij dhe dy fëmijët, kurse ...është person i verbër dhe asnjë anëtar i familjes nuk punon, ekzistencën e sigurojnë nga ndihma sociale, të ardhurat mujore i kanë 90.00 Euro. Gjithashtu i njëjti është person i sëmurë me probleme në zemër, yndyrë në gjak si dhe probleme me sheqer.

I padituri si prova ka paraqitur: letërnjoftimin si dhe Kartelën e Ndhmës Sociale.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim” lidhur me nenin 143 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, e lidhur edhe me nenin 10, paragrafi 1, poashtu të të njëjtit ligj se “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime” dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor, duke i kontribuar edhe ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare si dhe nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Me dispozitën e nenit 18 parag.1 të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia është paraparë se: “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”, ndërsa në paragrafin 4 të kësaj dispozite parshihet se: “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”. Sipas dispozitës së nenit 10 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve”.

Sipas dispozitës së nenin 136, parag.1 të Ligjit nr.04/L-007 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë se: “Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë që t’ia kompensoj, përveç nëse vërtetohet nëse dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Sipas dispozitës së nenit 137 të LMD-së është paraparë se “Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)...”, ndërsa sipas dispozitës së nenit 140 të po këtij ligji, është paraparë se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”.

Gjykata sa i përket kamatëvonesës ka vendosur në bazë të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 450 dhe 463 parag.1 të LPK-së, pasi që pala paditëse i ka kërkuar në padi shpenzimet mirëpo nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës ashtu siç parashihet me nenin 463 parag.1 të LPK-së.

Andaj, nga të cekurat më lartë dhe në bazë të nenit 152 të LPK-së, gjykata gjeti së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.3/19, me datën 21/10/2020

Gjyqtari ,
Blerim BESHTICA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate

Numri i lëndës: 2019:097519
Datë: 21.10.2020
Numri i dokumentit: 01206172